

PHILIPS

Sistemi Micro Music

Seria 8000

TAM8905



Manuali i përdoruesit

Përmbajtja

1	E rëndësishme	2
	Siguria	2
	Njoftim	3
2	Sistemi juaj Micro Music	4
	Hyrje	4
	Çfarë ka në kuti	4
	Përmbledhje e njësisë kryesore	5
	Përmbledhje për telekomandën	6
3	Fillimi	7
	Lidhja e bokseve	7
	Lidhja e antenës së radios	7
	Lidhja me energjinë	7
	Përgatitja e telekomandës	7
	Konfigurimi fillestar	8
	Ndezja	9
	Menuja e burimit	9
4	Dëgjimi i radios së internetit	10
	Përdorimi i menusë në modalitetin e radios së internetit	10
	Ruajtja e stacioneve të radios së internetit	11
	Zgjedhja e një stacioni radioje interneti	11
	Shfaq informacionet e radios së internetit	11
5	Dëgjimi i podkasteve	12
6	Dëgjimi i Spotify	12
7	Dëgjimi i radios DAB+	13
	Kalimi nëpër stacionet DAB+	13
	Ruajtja e stacioneve të radios DAB+	13
	Zgjedhja e një stacioni radioje DAB+	14
	Përdorimi i menusë në modalitetin DAB+	14
	Shfaqja e informacioneve DAB+	15
8	Dëgjimi i radios FM	16
	Kalimi nëpër stacionet FM	16
	Ruajtja e stacioneve të radios FM	16
	Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM	16
	Zgjedhja e një stacioni radioje FM të caktuar paraprakisht	16
	Përdorimi i menusë në modalitetin FM	17
	Shfaqja e informacioneve RDS	17
9	Përdorimi i menusë së parametrave të sistemit	18
	Rregullimi i parametrave të rrjetit	18
	Vendosja e orës dhe datës	18
	Vendosja e gjuhës së sistemit	19
	Rivendosja e të gjitha parametrave	19
	Shikimi i informacioneve të përditësimit të softuerit	19
	Përditësimi i firmuerit (nëse ka)	19
	Shikimi i versionit të softuerit	19
	Rregullimi i ndriçimit	19
10	Përdorimi i menusë kryesore	20
	Vendosja e alarmit	20
	Vendosja e kohëmatësit të gjumit	21
11	Veçori të tjera	22
	Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth	22
	Rregullo volumnin	22
	Heshnja e zërit	22
	Luajtja nga disku	22
	Luajtja nga USB	22
	Karikimi i pajisjeve	22
	Dëgjimi i një pajisjeje të jashtme	22
12	Informacione për produktin	23
	Specifikime	23
13	Zgjidhja e problemeve	24

1 E rëndësishme

Siguria

Duhet t'i lexoni dhe t'i kuptoni të gjitha udhëzimet para se ta përdorni sistemin e mikro muzikës.

Nëse shkaktohet ndonjë dëmtim nga mosndjekja e udhëzimeve, garancia është e pavlefshme.



Kjo shenjë rrufeje tregon se brenda pajisjes ka material të paizoluar, i cili mund të shkaktojë goditje elektrike. Për sigurinë e të gjithëve në familjen tuaj, ju lutemi mos e hiqni kapakun. "Pikëçuditja" tërheq vëmendjen ndaj veçorive për të cilat duhet të lexoni me kujdes literaturën e dhënë me qëllim që të parandalohen problemet e përdorimit dhe mirëmbajtjes. PARALAJMËRIM: Për të pakësuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, dhe objektet me lëngje, siç mund të jenë vazot nuk duhen vendosur mbi këtë pajisje.

KUJDES: Për të parandaluar goditjet elektrike, futeni spinën plotësisht. (Për zonat me priza të polarizuara: Për të parandaluar goditjet elektrike, futeni kunjën e gjerë në vrimën e gjerë.)

Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij aparati.
 - Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij aparati.
 - Asnjëherë mos shikoni rrezet e laserit që ndodhet brenda këtij aparati.
 - Asnjëherë mos e vendosni këtë aparat mbi pajisje të tjera elektrike.
 - Mbajeni aparatin larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
 - Sigurohuni që ta arrini gjithnjë me lehtësi kordonin e energjisë, spinën ose adaptorin për ta shkëputur aparatin nga energjia
-
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anëmbanë produktit për ajrim.
 - Përdorni vetëm shtesa/aksesorë të specifikuar nga prodhuesi
 - KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë - Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime të produktit:
 - Montojeni baterinë siç duhet, + dhe - siç është shënuar në produkt.
 - Bateria (e paketuar ose e instaluar) nuk duhet të ekspozohet në nxehtësi ekstreme si drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
 - Hiqeni baterinë kur produkti nuk do të përdoret për kohë të gjatë.
 - Produkti nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
 - Mos vini asnjë burim rreziku mbi produkt (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinjtë të ndezur).
 - Aty ku spina e energjisë ose një bashkues i pajisjes përdoret për si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.

Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim në pajisje, që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesve për ta përdorur pajisjen.

Pajtueshmëria

Këtu TP Vision Europe B.V. deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Deklaratën e konformitetit mund ta gjeni në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Asgjësimi i produktit dhe baterisë së vjetër



Produkti juaj është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi produktin do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/BE.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin të lehtë për t'u ndarë në tre materiale: karton (kutia), shumë polisteroli (amortizatori) dhe polietilen (qeset, fleta e shumës mbrojtëse.) Sistemi juaj përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Lutemi, respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të harxhuara dhe pajisjeve të vjetra.



Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë.



**Be responsible
Respect copyrights**

Bërja e kopjeve të paautorizuara të materialeve të mbrojtura, ku përfshihen programet kompjuterike, skedarët, transmetimet dhe regjistrimet me zë, mund të jetë shkelje e të drejtave të autorit dhe mund të përbërë arsye për ndjekje penale. Kjo pajisje nuk duhet të përdoret për qëllime të tilla.

Kujdesi për produktin

- Mos futni asnjë objekt, përveç disqeve në vendin e diskut.
- Mos futni disqe të deformuara ose të thyera në vendin e diskut.
- Hiqini disqet nga vendi i diskut nëse nuk do ta përdorni produktin për një kohë të gjatë.
- Përdorni vetëm leckë me mikrofibra për ta pastruar produktin.

Ky aparat ka këtë etiketë:



Shënim

- Etiketa e të dhënave ndodhet mbrapa produktit

2 Sistemi juaj Micro Music

Urime për blerjen tuaj dhe mirësevini te Philips! Për të përfutur plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support.

Hyrje

Me këtë pajisje ju:

- mund të dëgjoni audio nga disqet, pajisjet USB, pajisjet me Bluetooth dhe pajisjet e tjera të jashtme;
- mund të dëgjoni radio interneti me anë të lidhjes së rrjetit;
- mund të dëgjoni radio me transmetim FM dhe Digital Audio Broadcasting (DAB+);
- Mund ta karikoni pajisjen celulare nëpërmjet portës USB;

Pajisja mbështet këto formate audioje:





Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Njësia kryesore
- 2 bokse
- 2 x kordoni i energjisë AC
- 1 x antena e radios
- Teekomanda (me dy bateri AAA)
- Materialet e shtypura

Përmbledhje e njësisë kryesore



1 Çelësi SELECT

- Rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës ose në drejtim të kundërt për të lëvizur nëpër stacionet e radios.
- Rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës ose në drejtim të kundërt për të lëvizur nëpër listën e menusë.
- Shtypeni për të konfirmuar një zgjedhje.
- Mbajeni shtypur për të skanuar automatikisht të gjitha stacionet në modalitetin FM Tuner.


- 2 
- E ndez produktin ose e kalon në standby.

3 Sensori IR

- 4 
- Lidhni pajisje memorieje USB.


- 5  **SOURCE**
- Shtypni për të hyrë te menuja e burimit.

- 6  **AUDIO IN**
- Lidhni pajisjet e jashtme audio.


- 7  **MENU**
- Në modalitetin e punimit, hyni në menunë kryesore.
 - Mbajeni shtypur për të shfaqur informacion në modalitetin FM/DAB+.


- 8  **EARPHONE**
- Lidhni një pajisje kufjesh të jashtme.


- 9 
- Fillo ose ndalo luajtjen.


- 10 
- Ndaloni luajtjen.
 - Fshini një program.

11 Vendi i diskut

- 12 
- Kaloni te kënga e mëparshme/tjetër.
 - Kërkoni brenda një kënge/disku.
 - Shkoni te një stacion radioje.
 - Rregulloni orën.

- 13  **PRESET**
- Ruani stacionet e radios.
 - Shfaq stacionin e ruajtur paraprakisht

- 14 
- Hapni ose mbyllni vendin e diskut.

- 15  **Çelësi VOL/MUTE**
- Rrotullojeni për të rregulluar volumnin.
 - Shtypeni për të heshtur ose rikthyer zërin.


- 16 **Ekрани**
- Shfaqni statusin aktual.

- 17 **Antena FM/DAB+**
- Përmirësoni sinjalin FM/DAB+.

- 18 **Priza SPEAKER OUT**
- Bëni lidhjen me bokset.

- 19 **Priza AC IN**

Përmbledhje për telekomandën



① **⏻**

- E ndez produktin ose e kalon në standby.

② **↺ REPEAT**

- Zgjidhni modalitetin e luajtjes së përsëritur.

③ **PROG**

- Programoni këngët.

④ **📺 SOURCE**

- Shtypni për të hyrë te menaja e burimit.

⑤ **☰ MENU**

- Në modalitetin e punimit, hyni në menunë kryesore
- Mbajeni shtypur për të shfaqur informacion në modalitetin FM/DAB+.

⑥ **▲**

- Kaloni tek albumi tjetër.
- Rregulloni orën.

⑦ **⏮**

- Kaloni te kënga tjetër.
- Kërkoni brenda një kënge/disku/USB-je.
- Shkoni në një stacion FM.

⑧ **▶|| / OK**

- Shtypeni për të filluar, ndaluar ose vazhduar luajtjen ose për të konfirmuar zgjedhjen.

⑨ **▼**

- Kaloni tek albumi i mëparshëm.
- Rregulloni orën.

⑩ **SCAN**

- Ruani automatikisht stacionet e radios.

⑪ **VOL-**

- Uleni volumnin.

⑫ **EQ**

- Zgjidhni një efekt zëri të ruajtur paraprakisht.

⑬ **INFO**

- Shfaqni informacionet e luajtjes.

⑭ **PRESET**

- Shtypeni për të parë listën e stacioneve.
- Mbajeni shtypur për të ruajtur stacionin.

⑮ **Tastiera numerike (0-9)**

- Zgjidhni një këngë dixhitale ose radio të ruajtur paraprakisht

⑯ **CLOCK**

- Vendosni orën.
- Shikoni informacionet e orës.

⑰ **∞ RANDOM**

- Hyni në modalitetin e luajtjes së përzier.

⑱ **▲ OPEN/CLOSE**

- Hapni ose mbyllni vendin e diskut.

⑲ **BACK**

- Kthehuni te menaja e mëparshme nën këtë cilësim të menisë.

⑳ **▶▶**

- Kaloni te kënga tjetër.
- Kërkoni brenda një kënge/disku/USB-je.
- Shkoni në një stacion FM.

㉑ **■**

- Ndaloni luajtjen ose fshini një program.

㉒ **VOL+**

- Ngrijeni volumnin.

㉓ **🔇 MUTE**

- Heshtni ose riktheni volumnin.

㉔ **DIM**

- Rregulloni ndriçimin e ekranit.

㉕ **TIMER/SLEEP**

- Vendosni kohëmatësin e gjumit.
- Vendosni kohëmatësin e alarmit.

3 Fillimi

! Kujdes

- Përdorimi i kontrolleve ose bërja e rregullimeve, apo kryerja e procedurave të tjera që nuk janë përmendur këtu mund të shkaktojë ekspozim të rrezikshëm ndaj rrezatimit dhe funksionime të tjera të pasigurta.

Ndriqi gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.

Lidhja e bokseve


Shënimi

- Futni plotësisht në prizë pjesën e zhveshur të secilit tel boksi.
- Për cilësi më të mirë të zërit, përdorni vetëm bokset e dhëna.

- 1 Për boksin e djathtë, gjeni prizat mbrapa njësisë kryesore të shënuara me "R".
- 2 Vendoseni telin e kuq në prizën e kuqe (+), dhe telin e zi në prizën e zezë (-).
- 3 Për boksin e majtë, gjeni prizat në njësi të shënuara me "L".
- 4 Përsëritni hapin 2 për të futur telin e boksit të majtë.


Për të futur secilin tel të boksit:

- 1 Futni plotësisht telin e boksit.
- 2 Shtrengoni vidën.



Lidhja e antenës së radios


Lidhni antenën e radios me këtë produkt para se të dëgjoni radion.



Lidhja me energjinë

! Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë aparatit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Para se të lidhni kordonin e energjisë AC, sigurohuni që spina është e fiksuar mirë. Kur e shkëputni kordonin e energjisë AC, tërhiqni gjithnjë spinën, asnjëherë mos tërhiqni kordonin.
- Para se të lidhni kordonin e energjisë AC, sigurohuni që të keni bërë të gjitha lidhjet e tjera.



Lidhni kordonin e energjisë me prizën në mur.


Përgatitja e telekomandës

! Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të produktit! Kur telekomanda nuk do të përdoret për periudha të gjata, hiqni bateritë.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.

Për të futur baterinë e telekomandës:

- 1 Hapni kapakun e pjesës së baterive.
- 2 Vendosni baterinë AAA me polaritetin e duhur (+/-) siç është shënuar.
- 3 Mbylleni kapakun e pjesës së baterive.




Konfigurimi fillestar

- Kur aparati ndizet për herë të parë, **[Setup wizard]** shfaqet në ekran. Ndiqni udhëzimet e mëposhtme për të konfiguruar disa parametra bazë. Për të dëgjuar radion e internetit, duhet të konfiguroni lidhjen Wi-Fi më parë. Wi-Fi Protected Setup (WPS) është një standard i krijuar nga Wi-Fi Alliance për krijimin e rrjeteve të sigurta të valëve në rrjetin e shtëpisë. Nëse routeri juaj me valë mbështet WPS, mund ta lidhni shpejt dhe në mënyrë të sigurt radion nëpërmjet një prej dy metodave të konfigurimit: Push Button Configuration (PBC), ose Personal Identification Number (PIN). Për ata që nuk mbështetin WPS, keni një opsion tjetër për ta lidhur radion me routerin me valë.

Shënim

- Para se të lidheni me një rrjet, njihuni me routerin me valë.
- Sigurohuni që rrjeti Wi-Fi i shtëpisë suaj është i aktivizuar.
- Për sinjal më të mirë Wi-Fi, rrotulloni dhe rregulloni pozicionin e antenës Wi-Fi.

- 1 Kur shfaqet **[Setup wizard]**, rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur **[YES]** për të filluar konfigurimin. Nëse zgjidhni **[NO]**, do t'ju kërkohet ta hapni konfigurimin herës tjetër.



- 2 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
↳ **[12/24 hour format]** shfaqet.
- 3 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur formatin 12 ose 24 orë.
- 4 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
↳ **Shfaqet lista e përditësimit automatik.**

- 5 Përsëritni hapat 3 deri në 4 për të zgjedhur nëse doni të sinkronizoni orën me stacionet e radios.



- **[Update from DAB+]:** sinkronizoni orën me stacionet DAB+.
- **[Update from FM]:** sinkronizoni orën me stacionet FM.
- **[Update from Network]:** sinkronizoni orën me stacionet e radios në internet.
↳ Nëse zgjidhet **[Update from Network]**, përsëritni hapat 3 deri në 4 për të zgjedhur zonën orare, dhe më pas përsëritni hapat 3 deri në 4 për të vendosur ndërrimin e orës.
- **[No update]:** çaktivizoni sinkronizimin e orës.
↳ Nëse zgjidhet **[No update]**, përsëritni hapat 3 deri në 4 për të vendosur datën dhe orën.


- 6 Përsëritni hapat 3 deri në 4 për të zgjedhur **[YES]** për ta mbajtur rrjetin të lidhur.

- 7 Përsëritni hapat 3 deri në 4 për të zgjedhur rajonin WLAN.

- ↳ Radioja fillon të kërkojë automatikisht rrjetet e valëve.
- ↳ Shfaqet një listë e rrjeteve Wi-Fi të disponueshme.

- 8 Përsëritni hapat 3 deri në 4 për të zgjedhur rrjetin Wi-Fi.

- 9 Shtypni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një opsion për të lidhur routerin tuaj me valë:



- **[Push Button]:** zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë mbështet metodën e konfigurimit WPS dhe PBC. Do t'ju kërkohet ta shtypni butonin e lidhjes në router dhe më pas të shtypni **OK** për të vazhduar.

- **[Pin]:** zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë mbështet metodën e konfigurimit WPS dhe PIN. Radioja gjeneron një kod me 8 shifra të cilin mund ta vendosni në router
- **[Skip WPS]:** zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë nuk e mbështet WPS. Ju kërkohet të vendosni çelësin për rrjetin tuaj Wi-Fi

10 Siç ju kërkohet në ekran, shtypni butonin WPS për të vendosur PIN-in në routerin me valë, ose vendosni çelësin për t'u lidhur me rrjetin (Opsionet që shfaqen varen nga lloji i rrjetit dhe mbrojtja e përdorur).

- Kur vendosni çelësin e rrjetit, për të zgjedhur një karakter, rrotulloni **çelësin SELECT**, pastaj shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.



- Për të anuluar, rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur **[CANCEL]**.
- Për të konfirmuar atë që keni formuar, rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur **[OK]**.
- Për ta fshirë atë që keni formuar, rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur **[BKSP]**.
- Për të dalë nga procesi, shtypni **☰**.
↳ Nëse lidhja e rrjetit është krijuar, shfaqet **[Connected]**.

11 Kur shfaqet **[Setup wizard completed]**, shtypni **OK** për të dalë nga konfigurimi.



Këshillë

- Për disa routerë Wi-Fi, mund t'ju duhet ta mbani shtypur butonin WPS për lidhjen e Wi-Fi. Shikoni manualat e përdorimit për të parë hollësitë e routerëve specifikë.
- Për të hapur përsëri konfigurimin, zgjidhni menunë **[System settings]>[Setup wizard]** (shiko kapitullin "Përdorimi i menues së parametrave të sistemit").

Ndezja

- Shtypni **⏻**.
↳ Radioja kalon në burimin e zgjedhur për herë të fundit.

Kalimi në modalitet në pritje


- Shtypni **⏻** përsëri.
↳ Paneli i ekranit zbehet.
- ↳ Shfaqet data dhe ora (nëse janë vendosur).

Shënim

- Nëse sistemi është në gjendje joaktive për 15 minuta, aparati kalon automatikisht në gjendje pritjeje.

Menuja e burimit

Shtypni **☰** për të hyrë në menunë e burimit.



- 1 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur burimin
- 2 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar zgjedhjen

4 Dëgjimi i radios së internetit


Radioja mund të luajë me mijëra stacione radioje dhe podcaste nga anembanë bota nëpërmjet lidhjes së internetit.

Përdorimi i menusë në modalitetin e radios së internetit

Pasi të jetë bërë lidhja e internetit, do të shfaqet një listë me stacione. Më pas zgjidhni një për të filluar transmetimin.

Shënim


- Sigurohuni që rrjeti Wi-Fi i shtëpisë suaj është i aktivizuar. Për sinjal më të mirë Wi-Fi, rrotulloni dhe rregulloni pozicionin e antenës Wi-Fi.

1 Shtypni  **Source** dhe rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur modalitetin **[Internet radio]**.

- ↳ Radioja fillon të lidhet me rrjetin që ishte lidhur për herë të fundit, dhe pastaj ju çon në stacionin e radios me internet që po dëgjonit për herë të fundit.
- ↳ Nëse lidhja e rrjetit nuk është bërë më përpara, radioja fillon të kërkojë automatikisht rrjetet me valë (Shikoni pjesën "**Fillimi**">"**Konfigurimi fillestar**" ose "**Përdorimi i menusë së parametrave të sistemit**">"**Rregullimi i parametrave të rrjetit**" për të bërë një lidhje rrjeti).

2 Shtypni  **MENU** për të hapur menunë.


3 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të lëvizur nëpër opsionet e menusë:



- **[Station list]:** shkoni në çfarëdo stacioni radioje me internet që është i disponueshëm.
- **[System settings]:** rregulloni parametrat e sistemit (i njëjti opsion menuje për të gjitha modalitetet. Shikoni kapitullin "**Përdorimi i menusë së parametrave të sistemit**" për hollësi).
- **[Main menu]:** hyni në menunë kryesore (i njëjti opsion menuje për të gjitha modalitetet. Shikoni kapitullin "**Përdorimi i menusë kryesore**" për hollësi).

4 Për të zgjedhur një opsion, shtypni **çelësin SELECT**.

5 Përsëritni hapat 3 deri në 4 nëse ka ndonjë nën-opsion të disponueshëm poshtë një opsioni.

Për t'u kthyer te menuja e mëparshme, shtypni .

[Station list]

- **[Stations]:**
 - **[History]:** shfletoni stacionet e radios me internet sipas historisë.
 - **[Search]:** kërkonte stacione radioje në internet. Për të kërkuar, rrotulloni **çelësin SELECT** për të formuar një fjalë kyçe duke zgjedhur karakteret, më pas shtypni **çelësin SELECT** për të vazhduar.
 - **[Location]:** shfletoni stacionet e radios me internet sipas vendndodhjes.
 - **[Popular]:** shkoni te stacionet më të famshme në internet.
 - **[Discover]:** shkoni te lista e zbulimit për radion me internet.

Ruajtja e stacioneve të radios së internetit

Shënim

- Mund të ruani deri në 40 stacione të ruajtura paraprakisht (të ndara mes radios së internetit dhe Podkasteve)

- 1 Në modalitetin e radios së internetit, shkoni në një stacion radioje interneti.
- 2 Mbajeni shtypur ★ **PRESET** për dy sekonda.
 - ↳ Shfaqet lista e stacioneve të ruajtura paraprakisht.
- 3 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një numër të ruajtur paraprakisht
- 4 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
 - ↳ [**Preset stored**] shfaqet.
 - ↳ Stacioni ruhet në pozicionin e zgjedhur.

Zgjedhja e një stacioni radioje interneti

Në modalitetin e radios së internetit.

- 1 Shtypni ★ **PRESET**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një numër
- 3 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.




Shfaq informacionet e radios së internetit

Ndërsa dëgjoni radion e internetit, mbani shtypur ≡ **MENU** vazhdimisht për të lëvizur nëpër informacionet e mëposhtme (nëse ka):

- ↳ Emri i artistit dhe i këngës
- ↳ Përshkrim i stacionit
- ↳ Zhanri dhe vendndodhja e stacionit
- ↳ Codec dhe sampling rate
- ↳ Buffer i luajtjes
- ↳ Data

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet. Listat e nënstacioneve dhe nënmenutë mund të ndryshojnë herë pas here dhe ato janë të ndryshme sipas vendndodhjeve.

5 Dëgjimi i podkasteve

- 1 Shtypni  **Source** dhe rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur modalitetin [Podcasts].
- 2 Shtypni  **MENU** për të hapur menunë.
- 3 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të lëvizur nëpër opsionet e menusë:
- 4 Për të zgjedhur një opsion, shtypni **çelësin SELECT**.
- 5 Përsëritni hapat 3 deri në 4 nëse ka ndonjë nën-opsion të disponueshëm poshtë një opsioni.
Për t'u kthyer te menuja e mëparshme, shtypni .



6 Dëgjimi i Spotify


Përdorni telefonin, tabletën ose kompjuterin si telekomandë për Spotify. Shkoni në [spotify.com/connect](https://www.spotify.com/connect) për të mësuar si

Softueri Spotify është subjekt i licencave të palëve të treta që gjenden këtu: <https://www.spotify.com/connect/third-party-licenses>.

7 Dëgjimi i radios DAB+

Kalimi nëpër stacionet DAB+

Herën e parë që zgjidhni modalitetin e radios DAB+, ose nëse lista e stacioneve është bosh, radioja bën automatikisht një skanim të plotë.

- Shtypni  **Source** dhe rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur modalitetin **[DAB radio]**.
 - ↳ **[Scanning]** shfaqet.
 - ↳ Radioja skanon dhe ruan automatikisht të gjitha stacionet DAB+, dhe më pas transmeton stacionin e parë që është i disponueshëm.
 - ↳ Lista e stacioneve ruhet në memorien e radios. Kur të ndizni radion herës tjetër, nuk bëhet skanimi i stacioneve.

Për të shkuar në një stacion në listën e stacioneve të disponueshme:

- Në modalitetin DAB+, rrotulloni **çelësin SELECT** për të shkuar nëpër stacionet DAB+ të disponueshme.

Këshillë

- Stacionet mund të ndryshojnë herë pas here. Për të përditësuar listën e stacioneve, zgjidhni menunë **[Scan]** për të bërë skanimin e plotë.

Ruajtja e stacioneve të radios DAB+

Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje.

- 1 Në modalitetin DAB+, shkoni në një stacion radioje DAB+.
- 2 Mbajeni shtypur **★ PRESET** për dy sekonda.
 - ↳ Shfaqet lista e stacioneve të ruajtura paraprakisht.
- 3 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një numër të ruajtur paraprakisht
- 4 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
 - ↳ **[Preset stored]** shfaqet.
 - ↳ Stacioni ruhet në pozicionin e zgjedhur.

Zgjedhja e një stacioni radioje DAB+

Në modalitetin DAB+, keni dy mënyra për të zgjedhur një stacion radioje.

Mundësia A:


- 1 Shtypni ★ **PRESET**.
- 2 Rrotulloni çelësin **SELECT** për të zgjedhur një numër
- 3 Shtypni çelësin **SELECT** për të konfirmuar.

Mundësia B:

- Shtypni ◀◀/▶▶ për të kaluar te stacioni i mëparshëm/tjetër i ruajtur.

Përdorimi i menisë në modalitetin DAB+

- 1 Në modalitetin DAB+, shtypni ☰ **MENU** për të hapur menunë DAB+.
- 2 Rrotulloni çelësin **SELECT** për të lëvizur nëpër opsionet e menisë:



- **[Station list]:** shfaqni të gjitha stacionet e radios DAB+. Nëse nuk gjendet asnjë stacion, radioja fillon të skanojë stacionet DAB+ dhe t'i shtojë ato në listën e stacioneve
 - **[Scan]:** skanoni dhe ruani të gjitha stacionet DAB+ të disponueshme.
 - **[Manual tune]:** shkoni manualisht në një kanal/frekuencë të caktuar dhe shtojeni në listën e stacioneve
 - **[Prune invalid]:** fshini të gjitha stacionet e pavlefshme nga lista e stacioneve.
 - **[DRC]:** kompresoni gamën dinamike të sinjalit të radios në mënyrë që volumi i tingujve të qetë të rritet dhe volumi i tingujve të lartë të ulet.
 - **[Station order]:** ju jep mundësi të përcaktoni se si organizohen stacionet kur lëvizni nëpër listën e stacioneve.
 - **[System settings]:** rregulloni parametrat e sistemit (shikoni kapitullin "**Përdorimi i menisë së parametrave të sistemit**").
 - **[Main menu]:** hyni në menunë kryesore (shiko kapitullin "**Përdorimi i menisë kryesore**").
- 3 Për të zgjedhur një opsion, shtypni çelësin **SELECT**.
 - 4 Përsëritni hapat 2 deri në 3 nëse ka ndonjë nën-opsion të disponueshëm poshtë një opsioni.
 - Për t'u kthyer te menuja e mëparshme, shtypni ☰.

[Prune invalid]

- **[YES]:** fshini të gjitha stacionet e pavlefshme nga lista e stacioneve.
- **[No]:** kthehuni te menuja e mëparshme.

[DRC]

- **[DRC high]:** kalojeni DRC në një nivel të lartë (opsioni standard i rekomanduar për ambientet me zhurmë).
- **[DRC low]:** kalojeni DRC në një nivel të ulët.
- **[DRC off]:** fiken DRC.

[Station order]


- **[Alphanumeric]:** organizojini stacionet sipas rendit alfanumerik (konfigurimi standard).
- **[Ensemble]:** renditni grupet e stacioneve që transmetohen së bashku në të njëjtin ansambël (p.sh.: BBC ose South Wales lokal).
- **[Valid]:** renditni fillimisht stacionet e vlefshme, më pas stacionet off-air.



Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.



Shfaqja e informacioneve DAB+

Ndërkohë që dëgjoni radio DAB+, mbani shtypur  për të lëvizur nëpër informacionet e mëposhtme (nëse ka):

- ↳ Emri i stacionit
- ↳ Dynamic Label Segment (DLS)
- ↳ Fuqia e sinjalit
- ↳ Tipi i programit (PTY)
- ↳ Emri i ansamblit
- ↳ Frekuenca
- ↳ Ritmi i gabimeve në sinjal
- ↳ Bit-rate dhe statusi i audios
- ↳ Codec
- ↳ Ora dhe data

8 Dëgjimi i radios FM

Kalimi nëpër stacionet FM

- 1 Shtypni  **Source** dhe rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur modalitetin **[FM radio]**.
- 2 Mbani shtypur  për dy sekonda.
↳ Radioja kalon automatikisht në një stacion radioje FM me sinjal të fortë.
- 3 Përsëritni hapin 2 për të shkuar në më shumë stacione radioje.

Për të shkuar manualisht në një stacion:


- Në modalitetin e kërkimit FM, rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një frekuencë.

Ruajtja e stacioneve të radios FM



Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje FM.

- 1 Në modalitetin FM, shkoni në një stacion radioje FM.
- 2 Mbajeni shtypur  **PRESET** për dy sekonda.
↳ Shfaqet lista e stacioneve të ruajtura paraprakisht.
- 3 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një numër të ruajtur paraprakisht.
- 4 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
↳ **[Preset stored]** shfaqet.
↳ Stacioni ruhet në pozicionin e zgjedhur.

Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM

Në modalitetin FM, mbani shtypur **çelësin SELECT**

- ↳ Radioja i ruan të gjitha stacionet FM dhe transmeton stacionin e parë.




Këshillë

- Për ta fshirë një stacion të ruajtur, ruani një stacion tjetër në vend të tij.


Zgjedhja e një stacioni radioje FM të caktuar paraprakisht

Në modalitetin FM, keni dy mënyra për të zgjedhur një stacion radioje.


Mundësia A:

- 1 Shtypni  **PRESET**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një numër.
- 3 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.


Mundësia B:

Shtypni  për të kaluar te stacioni i mëparshëm/tjetër i ruajtur.

Përdorimi i menisë në modalitetin FM

- 1 Në modalitetin FM, shtypni  **MENU** për të hapur menunë FM.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të lëvizur nëpër opsionet e menisë:



- **[Scan setting]**
 - **[Audio setting]**
 - **[System settings]:** rregulloni parametrat e sistemit (shikoni kapitullin "**Përdorimi i menisë së parametrave të sistemit**").
 - **[Main menu]:** hyni në menunë kryesore (shiko kapitullin "**Përdorimi i menisë kryesore**").
- 3 Për të zgjedhur një opsion, shtypni **çelësin SELECT**.
 - 4 Përsëritni hapat 2 deri në 3 nëse ka ndonjë nën-opsion të disponueshëm poshtë një opsioni.
 - Për t'u kthyer te menuja e mëparshme, shtypni .

[Scan setting]

- **[Strong stations only?]-[YES]:** skanoni vetëm stacionet e radios FM që kanë sinjal të fortë.
- **[Strong stations only?]-[NO]:** skanoni të gjitha stacionet e radios FM që janë në dispozicion.

[Audio setting]

- **[Listen in Mono only?]-[YES]:** zgjidhni transmetimin mono.
- **[Listen in Mono only?]-[NO]:** zgjidhni transmetimin stereo.


Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.

Shfaqja e informacioneve RDS


RDS (Radio Data System) është një shërbim që u jep mundësi stacioneve FM të shfaqin informacione shitesë.


Nëse dëgjoni një stacion FM me sinjal RDS, do të shfaqet një ikonë RDS, si dhe emri i stacionit.

- 1 Shkoni në një stacion RDS.
- 2 Mbani shtypur  vazhdimisht për të lëvizur nëpër informacionet e mëposhtme (nëse ka):

- ↳ Emri i stacionit
- ↳ Mesazhet e radios
- ↳ Tipi i programit
- ↳ Frekuenca
- ↳ Data

9 Përdorimi i menisë së parametrevë të sistemit

- 1 Në modalitetin e punimit, shtypni  për të hapur menunë.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** vazhdimisht për të zgjedhur **[System settings]**.
- 3 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
- 4 Përsëritni hapat 2 deri në 3 për të zgjedhur një opsion.



- **[Equaliser]:** zgjidhni modalitetin e ekualizuesit.
- **[Network]:** ju jep mundësi të krijoni një lidhje rrjeti.
- **[Time/Date]:** vendosni orën dhe datën.
- **[Language]:** zgjidhni gjuhën e sistemit.
- **[Factory Reset]:** rivendoseni radion në statusin standard të fabrikës.
- **[Software update]:** kontrolloni informacionet e përditësimit të softuerit.
- **[Setup wizard]:** ju jep udhëzime për të bërë konfigurimin fillestar.
- **[Info]:** shikoni versionin e softuerit.
- **[Privacy policy]:** shikoni njoftimin për privatësinë.
- **[Backlight]:** rregulloni ndriçimin.

Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.

Rregullimi i parametrevë të rrjetit

- 1 Zgjidhni **[System settings]**>**[Network]**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një opsion ose nënopsion, më pas shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar. **[Network wizard]:** ju jep udhëzime për të krijuar një lidhje rrjeti.

- **[PBC Wlan setup]:** zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë mbështet metodën e konfigurimit WPS dhe PBC.
- **[View settings]:** shikoni informacionet aktuale të rrjetit.
- **[Manual settings]:**
 - **[DHCP enable]:** caktoni automatikisht adresën IP.
 - **[DHCP disable]:** caktoni manualisht adresën IP
- **[Network profile]:** shfaqni një listë rrjetesh që janë në memorien e radios.
- **[Clear network settings]:** fshini zgjedhjen e parametrevë të rrjetit.
- **[Keep network connected?]:** zgjidhni nëse doni ta mbani apo jo të lidhur rrjetin.

Vendosja e orës dhe datës

- 1 Zgjidhni **[System settings]**>**[Time/Date]**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një opsion ose nënopsion, më pas shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.



- **[Set Time/Date]:** vendosni orën dhe datën.
- **[Auto update]:**
 - **[Update from DAB+]:** sinkronizoni orën me stacionet DAB+.
 - **[Update from FM]:** sinkronizoni orën me stacionet FM.
 - **[Update from Network]:** sinkronizoni orën me stacionet e radios në internet.
 - **[No update]:** çaktivizoni sinkronizimin e orës.
- **[Set format]:** vendosni formatin 12/24 orë.
- **[Set timezone]:** vendosni zonën orare.
- **[Daylight savings]:** aktivizoni ose çaktivizoni ndërrimin e orës.

Shënim

- Nëse po e përditësoni orën nga DAB+ ose FM, opsioni i ndërrimit të orës nuk ka efekt.
- Nëse po e përditësoni nga rrjeti, vendosni zonën tuaj orare.

Shënim

- Nëse radioja zbulon se ka softuer të ri në dispozicion, ajo do t'ju kërkojë që të bëni përditësimin. Nëse jeni dakord, softueri i ri do të shkarkohet dhe instalohet.
- Para se të bëhet përditësimi, sigurohuni që radioja është e lidhur me një burim energjie stabilë. Shkëputja e energjisë gjatë një përditësimi të softuerit mund ta dëmtojë produktin.

Vendosja e gjuhës së sistemit

- 1 Zgjidhni **[System settings]** > **[Language]**.
↳ Shfaqet një listë e gjuhëve.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një gjuhë sistemi, më pas shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.

Rivendosja e të gjitha parametrave

- 1 Zgjidhni **[System settings]**>**[Factory Reset]**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një opsion, më pas shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
 - **[Yes]:** Rivendoseni radion në statusin standard të fabrikës.
 - **[No]:** Kthehuni te menuja e mëparshme.

Shikimi i informacioneve të përditësimit të softuerit

- 1 Zgjidhni **[System settings]**>**[Software update]**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një opsion ose nënopsion, më pas shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
 - **[Auto-check setting]:** zgjidhni nëse doni të kontrolloni rregullisht nëse ka versione të reja softueri.
 - **[Check now]:** kontrolloni menjëherë versionet e reja të softuerit

Shikimi i versionit të softuerit

- Zgjidhni **[System settings]**>**[Info]**.
↳ Shfaqet versioni aktual i softuerit.

Rregullimi i ndriçimit

- 1 Zgjidhni **[System settings]**>**[Backlight]**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** për të zgjedhur një opsion ose nënopsion, më pas shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
 - **[Timeout]:** zgjidhni kohën për ndriçimin e ekranit.
 - **[On level]:** zgjidhni një nivel ndriçimi.
 - **[Dim level]:** zgjidhni një nivel ndriçimi, mes mesatar, i ulët dhe i fikur.

10 Përdorimi i menisë kryesore

- 1 Në modalitetin e punimit, shtypni  për të hapur menunë kryesore.
- 2 Rotulloni **çelësin SELECT** vazhdimisht për të zgjedhur [Main menu].
- 3 Shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
- 4 Përsëritni hapat 2 deri në 3 për të zgjedhur një opson.
 - [Internet radio]: zgjidhni modalitetin e radios me internet.
 - [Podcasts]: zgjidhni modalitetin e radios Podcasts.
 - [Spotify]: zgjidhni modalitetin Spotify.
 - [DAB+]: zgjidhni modalitetin DAB+.
 - [FM]: zgjidhni modalitetin FM.
 - [CD]: zgjidhni modalitetin CD.
 - [USB]: zgjidhni modalitetin USB.
 - [Bluetooth]: zgjidhni modalitetin Bluetooth.
 - [AUDIO IN]: zgjidhni modalitetin AUDIO IN.
 - [Sleep]: vendosja e kohëmatësit të gjumit
 - [Alarms]: vendosni kohëmatësin e alarmit
 - [System settings]: rregulloni parametrat e sistemit (shikoni kapitullin "Përdorimi i menisë së parametrave të sistemit").

Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.
- Gjithashtu mund të shtypni **SOURCE** për të zgjedhur një modalitet:
Internet radio, Podcasts, Spotify, DAB+ radio, FM radio, CD, USB, Bluetooth ose AUDIO IN.

Vendosja e alarmit

Shënim

- Mund të vendosni dy alarme që të bien në orare të ndryshme. Për ta bërë alarmin të punojë normalisht, sigurohuni që ora të jetë vendosur si duhet.


- 1 Zgjidhni [Main menu]>[Alarms].
↳ Nëse nuk është vendosur ora, shfaqet një mesazh që të vendosni orën.
- 2 Shtypni **OK** për të vazhduar.
↳ Shifra e ditës pulson.

- 3 Rotulloni **çelësin SELECT** për të vendosur ditën, pastaj shtypni **çelësin SELECT** për të konfirmuar.
↳ Shifra e muajit pulson.
- 4 Përsëritni hapin 3 për të vendosur muajin, vitin dhe orën.
↳ Shfaqen opsionet [Alarm 1:off [00:00]] dhe [Alarm 2:off [00:00]].




- 5 Përsëritni hapin 3 për të zgjedhur [Alarm 1 :off [00:00]>[Enable:] [Off].
- 6 Përsëritni hapin 3 për të aktivizuar ose çaktivizuar kohëmatësin e alarmit
 - [Off]: çaktivizoni kohëmatësin e alarmit;
 - [Daily]: alarmi bie çdo ditë.
 - [Once]: alarmi bie vetëm një herë.
 - [Weekends]: alarmi bie të shtunave dhe të dielave.
 - [Weekdays]: alarmi bie çdo ditë nga e hëna në të premte.
- 7 Përsëritni hapin 3 për të zgjedhur [time], dhe më pas vendosni orën e alarmit.
- 8 Përsëritni hapin 3 për të zgjedhur [mode], dhe më pas vendosni burimin e alarmit.
 - [Buzzer]: zgjedh sinjalizuesin si burim alarmi.
 - [Internet radio]: zgjidhni stacionin e radios së internetit, që keni dëgjuar për herë të fundit, si burim alarmi.
 - [DAB+]: zgjidhni stacionin e radios DAB+, që keni dëgjuar për herë të fundit, si burim alarmi.
 - [FM]: zgjidhni stacionin e radios FM, që keni dëgjuar për herë të fundit, si burim alarmi.
- 9 Përsëritni hapin 3 për të zgjedhur [preset], dhe pastaj zgjidhni stacionin që keni dëgjuar për herë të fundit ose një stacion radioje të ruajtur si burim alarmi.
- 10 Përsëritni hapin 3 për të zgjedhur [Volume:], dhe më pas vendosni volumnin e alarmit.
- 11 Përsëritni hapin 3 për të zgjedhur [Save].
↳ Alarmi 1 vendoset.
- 12 Përsëritni hapat 5 deri në 11 për të vendosur alarmin 2.

Shënim

- Kur aktivizohet alarmi, shfaqet një ikonë alarmi për alarmin 1 ose alarmin 2.
- Për ta ndaluar alarmin, shtypni  në aparat.
- Gjithashtu mund të shkoni te **[System settings]>[Time/ Date]** për të vendosur orën dhe datën (shiko "**Përdorimi i menisë së parametrave të sistemit**">"**Vendosja e orës dhe datës**").


Vendosja e kohëmatësit të gjumit




- 1 Zgjidhni **[Main menu]>[Sleep]**.
- 2 Rrotulloni **çelësin SELECT** vazhdimisht për të zgjedhur periudhën e kohëmatësit të gjumit (në minuta).
 - ↳ Kur shfaqet **[Sleep OFF]**, kohëmatësi i gjumit çaktivizohet.

11 Veçori të tjera

Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth

1 Shtypni  **Source** dhe rrotulloni çelësin **SELECT** për të zgjedhur modalitetin **[Bluetooth]**.

2 Shtypni  **MENU** për të hapur menunë.

3 Rrotulloni çelësin **SELECT** për të lëvizur nëpër opsionet e menunë:

- Zgjidhni opsionin e menunë së çiftimit dhe shtypni çelësin **SELECT**.
- Mesazhi **"Ju lutemi lidheni pajisjen me: Philips TAM8905"** shfaqet me ikonën e Bluetooth që pulson.
- Në pajisjen tuaj me Bluetooth, aktivizoni Bluetooth dhe kërkoni pajisjet me Bluetooth që mund të çiftohen.
- Zgjidhni **[Philips TAM8905]** që shfaqet në pajisjen tuaj për çiftim.
- Pasi lidhja të jetë bërë me sukses, mesazhi i ekranit do të thotë **[Connected]** dhe ikona e Bluetooth do të ndalojë së pulsuar.

4 Për të zgjedhur një opsion, shtypni çelësin **SELECT**.

5 Përsëritni hapat 3 deri në 4 nëse ka ndonjë nën-opsion të disponueshëm poshtë një opsioni.

Për t'u kthyer te menuja e mëparshme, shtypni .



Rregullo volumin


- Gjatë luajtjes së muzikës, rrotulloni çelësin - **VOL+** për të rregulluar volumin.

Heshtja e zërit


- Gjatë luajtjes së muzikës, shtypni **MUTE** për të heshtur ose rikthyer zërin.


Luajtja nga disku

1 Shtypni  **Source** dhe rrotulloni çelësin **SELECT** për të zgjedhur burimin CD.

2 Shtypni  për ta hapur vendin e diskut.

3 Futni një disk me anën e etiketës lart.

4 Shtypni  për ta mbyllur vendin e diskut.

↳ Luajtja fillon automatikisht. Nëse jo, shtypni .


Luajtja nga USB

Shënim

- Sigurohuni që në pajisjen USB ka materiale audio që mund të luhen.

1 Futni një pajisje USB në  prizë.

2 Shtypni  **Source** dhe rrotulloni çelësin **SELECT** për të zgjedhur burimin USB.

↳ Luajtja fillon automatikisht. Nëse jo, shtypni .

Karikimi i pajisjeve

Me këtë sistem Micro Music, mund të karikoni pajisjet e jashtme, si telefonin celular, aparatin MP3 ose pajisjet e tjera celulare.

1 Përdorni një kabëll USB për ta lidhur prizën USB të këtij aparati me prizën USB të pajisjeve tuaja.

2 Lidhni produktin me energjinë.

↳ Karikimi fillon pasi të njihet pajisja.

Shënim


- Nuk garantohet pajtueshmëria e këtij produkti me të gjitha pajisjet.

Dëgjimi i një pajisjeje të jashtme

Mund të dëgjoni një pajisje të jashtme nëpërmjet kësaj njësie me një kabllo MP3 link.

1 Lidhni një kabllo MP3 link (nuk është dhënë) me:

- xhekun **AUDIO IN** (3.5 mm) në produkt,
- dhe xhekun e kufjeve në një pajisje të jashtme.

2 Shtypni  **Source** dhe rrotulloni çelësin **SELECT** për të zgjedhur modalitetin xhekun **AUDIO IN** si burim.

3 Filloni të luani në pajisje (shikoni manualin e përdorimit të pajisjes).

12 Informacione për produktin

Specifikime

Amplifikatori

Fuqia nominale output	50W*2 RMS
Përgjigjia e frekuencës	50-20000 Hz, ±3 dB
Raporti sinjal-zhurmë	> 65 dBA
Drajveri i boksit	2 × 5,25 rrezja e woofer, 4 Ω 2 × φ 25 mm rrezja e woofer, 12 Ω 2 × portë basi
Përforcim basi	
Niveli i hyrjes Audio	600 mV ±100 mV RMS
Lloji i diskut	CD-DA, CD-R, CDRW, MP3-CD(8/12 cm)
Luajtja e USB	Type A, USB direct 2.0, 5 V/1A, MSC format i skedarëve, FAT 16/32, Mbështet USB deri në 32 G
Karikimi me USB	2A maks (në pritje); 500 mA maks (burimi USB); 1 A maks (burim tjetër) * Shpejtësia e vërtetë e karikimit varet nga pajisjet portative

Wi-Fi

Protokolli Wi-Fi	802.11 b/g/n
Banda e frekuencës Wi-Fi	2412 MHz deri në 2472 MHz
Fuqia maksimale tranzit	15.08 dBm

Tuner

Rrezja e kërkimit(FM)	87.5-108 MHz
Rrezja e kërkimit(DAB/DAB+)	174.928-239.2 MHz (Band III)

Boksi

Impedanca e boksit	4 ohm
Ndeshmëria	86 ± 3 dB/m/W

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	V 4.2
Banda e frekuencës së Bluetooth	2.4 Ghz ~ 2.48 GHz ISM Band
Fuqia maksimale tranzit	-4,1 dBm
Rrezja e Bluetooth	10 m (hapësirë e lirë)

Informacion i përgjithshëm

Energjia AC (adaptor i energjisë)	Emri i markës PHILIPS
	Input: 100-240V~, 50/60Hz (AC Input)
Konsumi i energjisë gjatë punimit	≤45W
Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje (pa Wi-Fi)	≤1W

Përmasat

- Njësia kryesore (Gje x La x Tra)	230*145*262mm
- Kutia e boksit (Gje*La*Tra)	174*260,6*229mm

Pesha

- Njësia kryesore	2,17 kg
- Kutia e boksit	2*2,716 kg

13 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj pajisjeje.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni sistemin vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkoni shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të kenë gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që spina e energjisë AC të pajisjes të jetë lidhur si duhet.
- Sigurohuni që ka energji në prizën AC.

Nuk ka zë ose zëri është i dobët.

- Rregulloni volumnin.
- Kontrolloni nëse aparati është heshtur ose nëse stacioni i radios është ende duke u ngarkuar.
- Zgjatani plotësisht dhe lëvizeni pozicionin e antenës së radios.
- Mbajeni aparatin larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e radios.
- Kontrolloni lidhjen e rrjetit Wi-Fi.
- Rrotulloni dhe rregulloni pozicionin e antenës Wi-Fi.

Pajisja nuk përgjigjet

- Shkëputeni dhe lidhni përsëri spinën e energjisë AC, pastaj ndizeni pajisjen përsëri.
- Kontrolloni nëse aparati është në gjendjen në pritje. Nëse po, ndizeni aparatin.

Marrje e dobët e sinjalit

- Mbajeni aparatin larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e radios.
- Zgjatani plotësisht dhe lëvizeni pozicionin e antenës së radios.

- Kontrolloni lidhjen e rrjetit Wi-Fi. Rrotulloni dhe rregulloni pozicionin e antenës Wi-Fi.

Fuqia e sinjalit të Wi-Fi nuk është e mjaftueshme

- Kontrolloni distancën mes routerit dhe aparatit.
- Rrotulloni dhe rregulloni pozicionin e antenës Wi-Fi.

Nuk është e mundur të lidhet rrjeti Wi-Fi

- Kontrolloni nëse routeri juaj me valë është i fikur.
- Kontrolloni nëse routeri juaj me valë mbështet WPS. Përdorni metodën e duhur të konfigurimit (PBC ose PIN) për ta lidhur me radion routerin që ka WPS me aparatin. Nëse është e nevojshme, shikoni manualin e përdorimit të routerit me valë për të konfiguruar lidhjen e Wi-Fi.
- Konfiguroni përsëri parametrat e Wi-Fi (shiko "Fillimi">"Konfigurimi fillestar" dhe "Përdorimi i menisë së parametrave të sistemit">"Rregullimi i parametrave të rrjetit").

Ndonjëherë disa stacione nuk punojnë

- Disa stacione mund të pranojnë vetëm një numër të kufizuar dëgjuesish. Nëse provoni përsëri pas pak minutash, do të jeni në gjendje t'i dëgjoni stacionet.
- Stacioni nuk po transmeton. Provoni përsëri më vonë.

Disa stacione mund të zhduken nga lista e stacioneve

- Kur një stacion ndalon së transmetuari në interneti, ai do të hiqet nga lista. Aparati do të kontrollojë vazhdimisht nëse stacioni po transmeton. Nëse rifillon të transmetojë, ai do të rikthehet në listën e stacioneve.

Alarmi nuk punon

- Vendoseni si duhet orën/alarmin.



Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet me përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

